



Buletini

- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet tjera

Janar, 2019

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Trajnimi: Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale

Më 17 janar 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve në PTV, ka realizuar trajnimin për gjyqtarë dhe prokurorë me temë “Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale”.

Në kuadër të këtij trajnimi u elaborua çështjet rreth masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale. Vëmendje parësore iu kushtua paraburgimit si masë me të cilën sigurohet prezenca e të pandehurit si dhe të mbrohen qytetarët nga kryesi i veprës penale duke arritur efikasitet në procedurën penale.

Paraprakisht, u trajtuan edhe masa e arrestit shtëpiak, paraqitja në stacionin policor, ndalimi për të ju ofruar viktimës, dorëzania dhe masat tjera.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve pjesëmarrës në implementimin e drejtë të dispozitave dhe kushteve ligjore lidhur me rrethanat në të cilat mund të vendoset, duke përfshirë dhe standardet e përcaktuara me standardet ndërkombëtare për aplikim të paraburgimit si masa më e rëndë që mund të përcaktohet për sigurinë e të pandehurit në procedurë gjyqësore.

Metodologjia e aplikuar ishte e kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive si dhe puna në grupe e pjesëmarrësve.

Përfitues të këtyre trajnimeve ishin gjyqtar dhe prokuror nga të gjitha regjionet Kosovës.



Shqyrtimi paraprak i padisë

Më 21 janar 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-së organizoj trajnimin me temë: “Sigurimi i kërkesëpadisë”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me shqyrtimi paraprak të padisë si fazë e veçantë e procedurës kontestimore.

Në pjesën e parë u trajtuan çështjet që lidhen me prezumimet procedurale, klasifikimi i prezumimeve procedurale, prezumimet procedurale lidhur me gjykatën, prezumimet procedurale lidhur me palët, prezumimet procedurale lidhur me objektin e kontestit dhe prezumimet procedurale lidhur me padinë.



Në pjesën e dytë u bë identifikimi i pengesave procedurale në këtë fazë të procedurës, u trajtuan vendimet e gjykatës në evitimin e pengesave procedurale, hedhja poshtë e padisë si e palejuar, ekzistimi i kompetencës territoriale dhe i asaj lëndore si prezumim procedural dhe shtyrja e vendosjes për disa çështje si dhe përgjigjja në padi.

Më tej u konkludua se faza e shqyrtimit paraprak të padisë është një filtër që i ndihmon gjykatës në eliminimin e të gjitha pengesave në mënyrë që të vazhdohet me faza të tjera të procedurës. Kjo mundëson zbatimin e drejtë të dis-

pozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) sa i përket verifikimit të plotësimit të prezumimeve procedurale dhe atë: prezumimeve lidhur me gjykatën, palët, objektin e kontestit si dhe prezumimet lidhur me rregullsinë e padisë.

Në vazhdim u potencua se gjykatat duhet të jenë të kujdesshme kur vendosin që padinë ta kthejnë në plotësim duke kërkuar nga paditësi paraqitjen e fakteve mbi të cilat paditësi e bazon kërkesën e tij. Këshillohet që gjykatat ta kthejnë padinë në plotësim për këtë element vetëm në rastet kur në padi nuk është prezantuar asnjë fakt mbi të cilin paditësi e bazon kërkesën e tij. Këshillohet të vepohet në këtë formë sepse nëse paditësi nuk prezanton fakte sipas detyrimit të përcaktuar nga gjykata për plotësimin e padisë, atëherë gjykata do ta konsideroj të tërhequr padinë.

Gjithashtu u konkludua se nëse paditësi nuk e ka përmendur fare vlerën e objektit të kontestit në padi, apo në qoftë se ai vlerën e tillë e ka përcaktuar tepër të lartë apo shumë të vogël, atëherë gjykata sipas detyrës zyrtare apo sipas prapësimit të palës së paditur, me së voni në seancën përgatitore, e në qoftë se kjo nuk është mbajtur, atëherë në seancën për shqyrtim kryesor, por para së të filloj shqyrtimi shpejt dhe në mënyrë të përshtatshme do ta caktoj vlerën e objektit të kontestit.

Më tej u konkludua se në të gjitha rastet kur pala e paditur nuk paraqet fare përgjigje në padi brenda afatit të paraparë ligjor, për kundër faktit se aktvendimin me të gjitha provat materiale gjykata ia ka dërguar me kohë, atëherë nëse plotësohen kushtet ligjore të parapara me nenin 150 të LPK-së, gjykata do të nxjerr aktgjykim për shkak të mosbindjes, me të cilin do të aprovon në tersi kërkesëpadinë e paditësit.



Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore dhe duke u shoqëruar me diskutime interaktive, përmes materialit të ofruar nga trajnuesit, analizës së rasteve praktike, u zbërthyen dhe u sqaruan dispozitat e LPK-së që lidhen me këtë tematikë.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e gjykatave themelore të divizioneve civile nga departamentet e përgjithshme dhe bashkëpunëtorët profesional.

Procedurat alternative

Më 24 dhe 25 janar 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-së ka realizuar trajnimin me temë “Procedurat alternative”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me infrastrukturën ligjore e cila ndikon në zvogëlimin e shumë lëndëve në prokurori dhe gjykata.

Ky trajnim trajtoj procedurën alternative, procedurë kjo e cila ofronë mundësi për zgjidhjen e rasteve pa i dërguar ato në gjykatë, gjegjësisht pas negocimit të marrëveshjes, gjykata të vlerësoj këtë marrëveshje nëse do të pranoj si të tillë për procedim të mëtutjeshëm. Kjo është

veçanërisht e dobishme për të rritur efikasitetin dhe për të krijuar një sistem të drejtësisë penale që garanton një gjykim të drejtë të rasteve penale, por që e bënë këtë me shpejtësinë e duhur për ruajtjen e të drejtave të të gjitha palëve. Trajnimi i'u është përgjigjur pyetjeve dhe dilemave të cilat shfaqen në praktikë rreth zbatimit të procedurës alternative si mundësi më shpejtë për zgjidhjen e rasteve penale.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtar dhe prokuror nga niveli themelor nga të gjitha regjionet e Kosovës.



Personat juridik si kryes të kundërvajtjes

Më 28 janar 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të PTV-së ka realizuar trajnimin me temë “Personat juridik si kryes të kundërvajtjes”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të pjesëmarrësve në zbatimin e bazës ligjore për mënyrën e zhvillimit të procedurës kundërvajtëse ndaj subjekteve afariste si persona juridik, si dhe për rastet kur personi përgjegjës i personit juridik nuk mbanë përgjegjësi.

Në këtë trajnim u elaborua kush konsiderohet person përgjegjës në personin juridik, zhvillimi i procedurës ligjore ndaj subjekteve afariste si

biznese individuale, po ashtu u trajtua dallimi në mes të veprës kundërvajtje dhe asaj penale.

Gjatë trajnimit u aplikua metoda e kombinuar e prezantimit, ku përmes shembujve praktik dhe diskutimeve interaktive gjyqtarëve pjesëmarrës ju ofruan alternativa për paqartësitë dhe vështirësitë e zbatimit ligjit të ri për kundërvajtje në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë nga divizioni për kundërvajtje të gjykatave themelore nga gjitha regjionet.



“E Drejta në Pronë: Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”

Më 29 janar 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-së., organizoj trajnimin me temë: “E Drejta në Pronë: Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me të drejtën në pronë nga këndvështrimi i praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg.

Në pjesën e parë u zbërthyen tre rregullat e nenit 1. të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ) – me theksë në mënyratë e vleresimit të shkëlqeve nga GJEDNJ, pranueshmëria e Kërkesës, konceptet kryesore, pasuria dhe pritja legjitime. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan ndërhyrjet në gëzimin paqësor të pasurisë, proporcionaliteti dhe arritja e barazpeshës së drejtë dhe rastet problematike nga shtetet e Ballkanit perëndimor me fokus në shpronësim dhe rikthim të pasurisë.

Që në fillim u theksua se e drejta në pronë është e drejtë e garantuar me Neni 1. të Protokollit 1 të KEDNJ. Ndonëse teksti themelor i Konventës është miratuar në vitin 1950 nga Këshilli i Evropës, e drejta në pronë nuk ishte e përfshirë në të deri në vitin 1952, kur u miratua Protokollin i parë i kësaj Konventeje.

Kjo vonesë mund të shpjegohet me hezitimet që disa shtete, veqanërisht Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar, i kishin në lidhje me garantimin e kësaj të drejteje për shkak të frikës se kjo mund të ndërhynte me planet e tyre për nacionalizim dhe prandaj teksti siq është sot lejon hapsirë të konsiderueshme për ndërhyrjet e shtetit në gëzimin paqësor të pasurisë.

Në vazhdim u konkludua se thelbi i ndërhyrjes në gëzimin paqësor të pasurisë është që të ketë pasur shuarje a kufizim të të drejtave të pronarëve. Për tu përmbushur ky kusht, GJEDNJ nuk i merr parasysh vetëm situatat kur ka pasur shpronësim formal apo transfer të pronës, por edhe situatat kur ky shpronësim a kufizim mund të ketë ndodhur de facto.

Gjithashtu u konkludua se koncepti i “pasurisë” sipas nenit 1 të Protokollit 1 ka kuptim autonom, andaj si term duhet interpretuar pavarësisht nga cilësimi formal në të drejtën e brendshme të shteteve anëtare.

Pavarësisht kësaj termi “pasuri interpretohet gjerësisht nga GJEDNJ. Në kuadër të këtij termi, sot hyjnë jo vetëm prona e luajtshme dhe e paluajtshme, por edhe aksionet, pronësia intelektuale, vendimet finale të dhomave të arbitrazhit dhe gjykatave, e drejta e pensionit, e drejta në qira, dhe madje edhe të drejtat që rrjedhin nga zhvillimet e një biznesi.

Më tej u konkludua se pjesa e dytë e këtij neni kërkon që çfardo ndërhyrje apo privim nga kjo, gëzimi paqësor i pasurisë të jetë bërë në përputhje me ligjin. Parimi i ligjshmërisë në kuadër të këtij neni kërkon që ndërhyrjet të dispozitat e aplikueshme të ligjit vendor të jenë të qasshme, të qarta, dhe të parashikueshme.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore e GJEDNJ dhe duke u shoqëruar me diskutime interaktive, përmes materialit të ofruar nga trajnuesit, analizës së rasteve praktike, u zbërthyen dhe u sqaruan dispozitat e nenit 1. të protokollit 1. të KEDNJ.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e gjykatave themelore të divizioneve civile nga departamentet e përgjithshme dhe Gjykatës së Apelit.

Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes së parave

Më 30 dhe 31 janar 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-së ka realizuar trajnimin me temë “Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes së parasë”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me infrastrukturën ligjore për luftimin e shpëlarjes së parave, për format apo veprimet që duhet ndërmarrë për hetimin dhe gjykimin e shpërlarjes së parave si dhe për problemet të cilat paraqiten në praktikë me qëllim që të zbatohen në mënyrë efikase mekanizmat përkatës.

Me rastin e këtij trajnimi u trajtuan veprat penale

të shpëlarjes së parave, format e manifestimit të kriminalitetit si: evazionet fiskale, aktivitete të ndryshme kriminale, pastrimi i parave, etj. Nga ajo që u vu në pah ishte se gjitha veprat penale që ndërlidhen me shpëlarjen e parasë kryhen me ndërmarrjen e aktiviteteve kriminale dhe se këto vepra penale kërcënojnë seriozisht zhvillimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës duke cenuar të drejtat e njeriut, sigurinë dhe zhvillimin ekonomik të shtetit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtar nga Apeli, gjyqtar dhe prokuror nga niveli themelor nga të gjitha regjionet e Kosovës.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapo emëruar gjatë muajit Janar 2019

Gjatë muajit Janar 2019, në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapoemëruar, janë zhvilluar aktivitete si në trajnimin teorik po ashtu edhe në trajnimin praktik.

Në këtë periudhë në trajnimin teorik janë realizuar gjithsejtë gjashtë (16) sesione trajnues nga modulet: “Kodi i Procedurës Penale”, “Shkathësitë personale dhe ndërpersonale” “Legjislacioni dhe shkathësitë plotësuese”, dhe “Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar”.

Nga nën moduli “Menaxhimi i rasteve” janë realizuar tre (3) sesione trajnuese, ku prokurorët kanë pasur mundësi të thellojnë njohurit e tyre rreth kuptimit të menaxhimit, planifikimit në bazë të objektivave, planifikimit të rastit nga prokurori, mbledhja e materialit për dosje, planifikimi i masave individuale, kuptimi dhe rëndësia e dëshmive në procedurën penale, burimet e dëshmive, struktura e dosjes hetimore etj.

Gjithashtu në kuadër të nën modulit “Organizimi i sistemit gjyqësor dhe prokurorial” janë realizuar dy (2) sesione trajnuese, ku pjesëmarrësit kanë pasur mundësi të diskutojnë rreth organizimit të ri të sistemit gjyqësor në Kosovë, veprimtarinë e Gjykatës Themelore, të Apelit dhe Supreme, bazën ligjore të Këshillit Prokurorial, struktura organizative e prokurorisë, mandati i anëtarëve të Këshillit, vlerësimi i performancës së prokurorëve, dhe komisioni disiplinor.

Sipas programit trajnues prokurorët e sapo emëruar kanë realizuar dy (2) sesione trajnuese nga nën moduli “Arsyetimi i vendimeve (ankesave/akteve akuzuese)” dhe kanë shtjelluar njohurit bazë të shkrimit ligjor të çdo dokumenti ligjor, duke filluar nga kombinimin i elementeve materiale me ato procedurale në lidhshmëri me

faktet për një çështje të shtruar për zgjidhje, mënyrën efikase dhe metodologjinë e të shkruarit ligjor IRAC, parimet e shkrimit ligjor, analiza e normës ligjore, si dhe krahasimi i shkrimit ligjor mes SHBA dhe Kosovës.

Në periudhën raportuese prokurorët e sapo emëruar nga moduli “Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar” kanë realizuar një (1) sesion trajnues ku kanë trajtuar: Bashkëpunimin juridik ndërkombëtar, kufizimet e bashkëpunimit, procedura e ekstradimit, procedura dhe shqyrtimi i thjeshtësuar i ekstradimit, transferimi i procedurave penale, konfiskimi i të ardhurave nga krimi, hetimet e përbashkëta, si dhe hartimin e një kërkesë efektive.

Nga nën moduli “Shpenzimet e procedurës dhe kërkesat pasurore juridike” është realizuar një (1) sesion trajnues ku prokurorët e sapo emëruar kanë pasur rastin të diskutojnë rreth parapagimit të shpenzimeve të procedurës penale, shpenzimet e përkthimit në rastet e mbrojtjes së detyruar, vendimi për shpenzimet e procedurës penale, personat e autorizuar për paraqitjen e kërkesës pasurore juridike, kthimi i sendit, masat e përkohshme për sigurimin e kërkesës pasurore juridike.

Gjithashtu nga nën moduli: Kodi i drejtësisë për të mitur, prokurorët e sapo emëruar kanë realizuar një (1) sesion trajnues ku kanë diskutuar për moshën e përgjegjësisë penale, urgjenca e procedurës dhe afatet e shkurtuara, mos gjykimi në mungesë të të miturit, procedura përgatitore ndaj të miturve, pushimi i procedurës përgatitore, ndarja dhe bashkimi i procedurës penale, masat edukative, masat e diversitetit, trupi gjykues për të mitur etj.



Gjatë muajit Janar prokurorët e sapo emëruar kanë realizuar edhe 6 sesione trajnuese nga moduli: Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese, nën moduli: “Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore”. Në kuadër të trajnimit prokurorët kanë pasur rastin të shtjellojnë temat si: Fjala hyrëse, mbrojtja e klientit, struktura e fjalës hyrëse, kuptimi i marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje, dëshmitarët negativ dhe armiqësor, marrja e tërthortë në pyetje, vënia në dyshim, dëshmitari mohues, riekzaminimi, dhe fjala përfundimtare.

Në periudhën raportuese prokurorët e sapo emëruar kanë realizuar dhe 1 vizitë në

Agjencinë Kadastrale të Kosovës sipas programit trajnues.

Për këtë periudhë prokurorët e sapo emëruar kanë realizuar (13) ditë trajnimi praktikë në prokurorit përkatëse ashtu siç është paraparë me programin trajnues.

Trajnimin fillestar janë duke e ndjekur 21 prokuror të sapo emëruar, dy prej tyre janë të komunitetit serb.

Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar gjatë muajit Janar 2019

Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar gjatë muajit Janar 2019

Akademia e Drejtësisë, me qëllim të përmbushjes së programit trajnues, ka vazhduar me realizimin e aktiviteteve të planifikuara në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar, të cilin janë duke e vijuar gjyqtarët e sapo emëruar.

Në kuadër të trajnimit teorik janë realizuar gjithsejtë 18 sesione trajnuese nga modulet: Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

Nga moduli: “Kodi Penal” janë realizuar 16 sesione trajnuese, ku janë trajtuar këto tema si në vijimë: Ndarja e veprave penale, deliktet ekonomike, kundërvajtjet dhe veprat penale, kuptimi i veprimit, dhuna dhe kanosja, kauzaliteti, vendi dhe koha e kryerjes së veprës penale, kundërligjshmëria, raporti mes kundërligjshmërisë dhe rrezikshmërisë, elementet e përgjegjësisë penale, faji, dashja, pakujdesia, lajthimi, tentativa, shtytja për kryerjen e veprës penale, dënimet alternative, dënimet plotësuese, karakteristikat e ekzekutimit të sanksioneve penale, veprat penale nga kapitulli XX (sulmi seksual,

keqpërdorimi seksual), veprat penale nga kapitulli XVII, keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjeçare, përdorimi, prodhimi dhe përpunimi i lëndëve narkotike, falsifikimi i parasë, vjedhja, grabitja, shmangia nga tatimi, uzurpimi i palejueshëm i pronës, dhe ngasja në gjendje të paaftë.

Nga nën moduli: Veprat penale të korrupsionit dhe kundër detyrës zyrtare është realizuar një (1) sesion trajnues ku gjyqtarët e sapo emëruar kanë pasur mundësi të avancojnë njohurit e tyre rreth veprave penale të korrupsionit sipas kodit të procedurës, keqpërdorimit të pozitës zyrtare, konfliktit të interesit, dhe përdorimi i paautorizuar i pasurisë.

Gjithashtu nga nën moduli: Krimet e rënda është realizuar një (1) sesion trajnues dhe janë trajtuar këto tema: Trafikimi me qenie njerëzore, heqja e organeve, pëlqimi të personat madhor, pëlqimi tek personat e mitur, njësia për intelegjencë financiare, krimet kibernetike, dhe terrorizmi.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 11 ditë trajnim praktik në gjykata konform orarit të përcaktuar. Trajnimin fillestar janë duke e ndjekur pesë (5) gjyqtarë të komunitetit serb.



Raporti i vizitës së prokurorëve të sapo emëruar (Gjenerata VII) në Agjencinë Kadastrale të Kosovës

Më 31 janar 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të programit të trajnimeve fillestare, organizoi për prokurorët e sapo emëruar (gjenerata VII) vizitë në “Agjencinë Kadastrale të Kosovës”.

Në kuadër të kësaj vizite, prokurorët u njoftuan për së afërmi me : ligjshmërinë, punën, veprimtarinë, dhe problemet me të cilat ballafaqohet ky institucion.

Në vizitën e prokurorëve në këtë Agjenci u bë një përmbledhje e shkurtë rreth punëve, aktiviteteve si dhe ligjeve dhe sistemeve që përdor Agjencia Kadastrale e Kosovës për administrimin e regjistrave pronësorë, me theks të veçantë pjesën tekstuale dhe grafike të të dhënave pronësore.

Gjatë trajnimit prokurorët u njoftuan me objektivat e Agjencisë të cilat kanë të bëjnë me:

Regjistrimin e parcelave, ndërtesave, objekteve afariste, dhënja e lejeve për banim, emërimi i rrugëve, fotografimi i objekteve të banimit dhe vendosja e tyre në harta topografike, punët gjeodezike, dhe matjet shtetërore. Në fokus kishin edhe shqyrtimin e E-Kioskut sistem i ri për marrjen e certifikatës së pronës.

Prokurorët shpalosën ankesa dhe kërkesa, dhe prezantuan sfidat me të cilat ballafaqohen gjatë trajtimit të lëndëve. Po ashtu, prokurorët dhe ekspertët e AKK-së trajtuan edhe mundësinë e ngritjes së shkallës së bashkëpunimit sa i përket shpërndarjes së informacioneve të sakta dhe kualitative.

Përfitues të trajnimit ishin Prokurorët e sapo emëruar (gjenerata VII) 2018-2019.



Aktivitetet tjera

Takimi i Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë me Dekanin e Fakultetit Juridik të Kolegjit “AAB”

Prishtinë, 04 janar 2019, Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë, z. Valon Kurtaj, ka pritur në takim Dekanin e Fakultetit Juridik të Kolegjit “AAB” z. Veton Vula dhe Prodekanin z. Fatmir Qollakaj.

Drejtori i njoftoi mysafirët me punën e Akademisë së Drejtësisë, programet e trajnimit për gjyqtarë, prokurorë dhe profesionistë tjerë, programet e shkëmbimit si dhe programin e praktikës me studentët.

Në anën tjetër z. Vula u fokusua veçanërisht tek programi mësimor i Fakultetit Juridik të Kolegjit “AAB” në përgatitjen e studentëve me

qëllim që të jenë të gatshëm të përfshihen në procesin e punës pas përfundimit të studimeve.

Këtu u potencua nevoja që studentët të përfshihen në programe praktike në institucione, në mënyrë që të plotësohet edhe aspekti praktik i formimit profesional të tyre.

Në fund të takimit të dyja palët u pajtuan për thellimin e bashkëpunimit me nënshkrimin e një Marrëveshje Bashkëpunimi ku do të përcaktohen të gjitha aspektet e bashkëpunimit ndërinstytucional në funksion të zhvillimit profesional të përfituesve të dy institucioneve.



Nënshkruhet memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Akademisë së Drejtësisë dhe Fakultetit Juridik të Kolegjit AAB

Prishtinë 11 janar 2019, z. Valon Kurtaj - Drejtori Ekzekutiv dhe z. Besim Morina-Koordinatori i Programit në Akademinë e Drejtësisë zhvilluan një takim miqësor me përfaqësues të Fakultetit Juridik të Kolegjit AAB.



Qëllimi i këtij takimi ishte nënshkrimi i memorandumit të mirëkuptimit për mbajtjen e praktikës së studentëve të Fakultetit Juridik të këtij Kolegji në Akademinë e Drejtësisë.

Të dy palët u pajtuan të organizojnë aktivitete të përbashkëta profesionale me qëllim të shkëmbimit të praktikave në drejtim të rritjes së cilësisë së programit të trajnimit praktik për studentët. Dhe gjithashtu u pajtuan që është e domosdoshme që të kenë projekte të përbashkëta kërkimore, shkencore dhe hulumtuese.

Gjatë kësaj vizite në Kolegjin AAB, përfaqësuesit e Akademisë së Drejtësisë mbajtën edhe një ligjëratë dhe bashkëbiseduan me studentët e Fakultetit Juridik, duke i njoftuar më afër me fushë veprimtarinë dhe rolin e Akademisë së Drejtësisë në ngritjen e kapaciteteve në sistemin Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës.



Vazhdon mbështetja e UNDP-së për Akademinë e Drejtësisë

Prishtinë 18 janar 2019, Në vazhdimësi të bashkëpunimit të mirë është zhvilluar një takim ndërmjet përfaqësuesve të Akademisë së Drejtësisë dhe UNDP-së.

Në fillim të këtij takimi z. Valon Kurtaj - Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë, shprehu mirënjohjen dhe falënderimin e tij për UNDP-në, si përkrahëse e Akademisë në përmbushjen e mandatit të saj dhe realizimin e aktiviteteve gjatë viteve të kaluara dhe gatishmërinë për mbështetje edhe gjatë vitit 2019.

Disa nga temat e bashkëpunimit të ndërsjellë që diskutuan gjatë takimit janë: organizimi i trajnimeve për Agjencinë për ndihmë juridike falas; organizimi i trajnimeve për zhvillimin e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të integruar në sistemin gjyqësor dhe prokurorial; ngritja e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me KEDNJ; publikimi i

doracakëve dhe materialeve për harmonizimin e praktikës gjyqësore; mbështetje në ngritjen e kapaciteteve të stafit të Akademisë; mbështetje në fushën e përkthimeve dhe në përditësimin e platformës së mësimin në distancë.

z. Ardian Latifaj, Menaxher i Projektit “Mbështetje për Forcimin e Sundimit të Ligjit në Kosovë” edhe gjatë këtij takimi ritheksoi se bashkëpunimi me Akademinë e Drejtësisë është i një rëndësie të veçantë dhe se UNDP do të mbështes Akademinë edhe më tutje me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të sistemit gjyqësor, prokurorial dhe profesionistëve ligjor në Kosovë.

Në fund të takimit, të dy palët u koordinuan për kohën e realizimit të aktiviteteve që u diskutuan.



Vazhdon bashkëpunimi i mirë AD - KPK

Prishtinë, 21 janar 2019, z. Valon Kurtaj - Drejtor Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë ka vizituar Këshillin Prokurorial të Kosovës, ku ka zhvilluar një takim me z. Bahri Hyseni - Kryesuesin e ri të KPK-së dhe z. Lavdim



Krasniqi - Drejtor i Sekretariatit të këtij institucioni.

z. Kurtaj fillimisht uroi kryesuesin Hyseni për pozitën e re duke i uruar punë të mbarë në arritjen e qëllimeve për një sistem prokurorial

sa më efikas.

z. Hyseni shprehu gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit të ngushtë me Akademinë e Drejtësisë edhe gjatë mandatit të tij si kryesues i KPK-së.

Gjatë këtij takimi u diskutua për realizimin e planeve të trajnimeve, në veçanti për Programin e Trajnimeve Fillestare për prokurorë të cilët do të rekrutohen gjatë vitit 2019, por edhe për Programin e Trajnimeve të Vazhdueshme ku përfshihen ndryshimet në legjislacionin penal dhe reformat në strukturën organizative të prokurorive.

Në fund të takimit bashkëbiseduesit u pajtuan që të vazhdoj koordinimi dhe bashkëpunimi për trajnimet e organizuara nga Akademia e Drejtësisë si pikë kyçe për ngritjen e kapaciteteve të prokurorëve dhe stafit administrativ të sistemit prokurorial.

Takim me përfaqësues të Ambasadës Amerikane

Prishtinë, 22 janar 2019, z. Valon Kurtaj, Drejtor Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë ka pritur në takim përfaqësues të Ambasadës Amerikane në Prishtinë.

Temë kryesore e diskutimit në këtë takim ishte bashkëpunimi në realizimin e trajnimeve në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale pas ndryshimeve legjislative të këtyre kodeve të cilat priten të hynë në fuqi gjatë këtij viti.

Përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane ritheksuan se do të ofrojnë gjithë mbështetjen për organizimin e këtyre trajnimeve dhe trajnimeve të tjera sipas mandatit të

Akademisë së Drejtësisë duke kontribuar në ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve.



Seminari Regjional për Sundimin e Ligjit dhe Etikën Gjyqësore

Me 24-25 janar 2019, nën organizimin e TAIEX dhe Qendrës për Trajnimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të Malit të Zi, në Podgoricë është mbajtur “Seminari Regjional për Sundimin e Ligjit dhe Etikën Gjyqësore”.



Në këtë organizim regjional, prezantuan delegacione nga shtetet e regjionit dhe atë nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Maqedonia dhe Kosova. Delegacioni kosovar u përfaqësua nga Valon Kurtaj – drejtor i Akademisë së Drejtësisë, Hilmi Bajrami – gjyqtar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, Mahir Tutuli – gjyqtar në Gjykatën e Apelit dhe Ardian Hajdari – prokuror në Departamentin e Krimeve të Rënda në Prokurorinë Themelore në Pejë.

Dita e parë e seminarit filloi me fjalimin e znj. Senka Dailoviç – presidente e Komitetit

Drejtues të seminarit dhe drejtoreshë e Qendrës për Trajnimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Mal të Zi, e duke u pasuar nga znj. Doris Obereder – gjyqtare dhe anëtare në Këshillin Etikës Gjyqësore pranë Asociacionit të Gjyqtarëve në Austri dhe z. Zhelko Pajaliq – gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kroacisë. Folësit në fjalimet dhe prezantimet e tyre i kushtuan një rëndësi të veçantë pavarësisë së gjyqësorit dhe etikës profesionale, duke shkëmbyer informata të rëndësishme mbi përvojat në shtetet e tyre dhe përvojat e BE-së, për pavarësinë e gjyqësorit dhe etikën profesionale.

Dita e parë përfundoi me prezantimin e znj. Maria Dimitrova, përfaqësuese e Qeverisë Bullgare në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila prezantoi eksperiencën e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në raport me pavarësinë gjyqësore dhe etikën profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Në ditën e dytë pjesëmarrësit u morën me trajtimin e etikës gjyqësore dhe përgjegjësisë disiplinore me rastin e shkeljeve etike.



<https://ad.rks-gov.net>

**Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660
Fax: + 381 38 512 095
E-mail: infoad@rks-gov.net**